

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPSTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PREDSEDNIKA OPSTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1471 Nr. i faq/Br. str./No. pg 391
Data/Datum/Date 29/1/22
RAHOVEC/ORAHOVAC



KOMUNA
RAHOVEC

PROCESVERBALI NGA TAKIMI ME PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS KOMUNALE I KRYETARIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Zyra e Kryetarit

**Adresa: Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut
p.n,21000, Rahovec –Kosovës**

Tel :0382004534

PROCESVERBALI NGA TAKIMI ME PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS KOMUNALE I KRYETARIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, kryetari i komunës së Rahovecit z. Smajl Latifi edhe në vitin 2022 ka vazhduar takimet me punonjësit e administratës komunale.

Takimin e ftoi dhe e kryesoi z. Smajl Latifi, Kryetari i Komunës të Komunës së Rahovecit. Takimi është mbajtur sot më 21.01.2022 (e premte), në Sallën e Kuvendit Komunal Rahovec, duke filluar në ora 09:03.

Në takim morën pjesë:

1. Kryetari i Komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi
2. Nënkryetari i Komunës, z. Fatmir Iska
3. Drejtori i Drejtorisë së Administratës, z. Besnik Hoti
4. Punonjësit e administratës.
5. Punonjësit e QPS-së.

REND DITE

- Bashkëbisedim (takim i rregullt) për të gjitha çështjet që e preokupojnë administratën komunale

Drejtori i Drejtorisë së Administratës, z. Besnik Hoti- Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

Fillimisht ju uroj për punën dhe angazhimin që keni pasur deri më tani por tani edhe në cilësinë e drejtorit të Administratës kërkoj angazhimin tuaj të mëtutjeshëm për punët dhe angazhimet që keni para vetes në përputhje me detyrimet të cilat janë të parapara me ligj.

Shërbimet komunale janë të rëndësishme për qytetarët, prandaj Komuna e Rahovecit do të investojë në vazhdimësi në modernizimin dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.

Për këtë kërkoj nga të gjithë ju angazhim dhe bashkëpunim si dhe uroj që përkushtimi të jetë edhe më i madh në vazhdim në dhënien e shërbimeve karshi qytetarëve.

Kërkesë e imja primare është poashtu që të respektohet orari i punës, i cili është obligim ligjor dhe që buron nga kontrata.

Kryetari i Komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi- Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pasi që është takimi i parë për këtë vit, uroj që ky vit të shkoj mirë për ju dhe të keni suksese në punën tuaj që bëni karshi qytetarëve, për punën e mirë që bëni ju ne si institucion po vlerësohemi me nota pozitive nga institucione vendore dhe ato ndërkombëtare.

Jemi të detyruar që tash e tutje me vazhdu me një kujdes të shtuar për mbarëvajtjen e vijueshmërisë së punonjësve, pasi që është një prej kërkesave (gjetjeve) të Zyrës Kombëtare të Auditimit (raporti i vijueshmërisë).

Ju njoftoj juve dhe përmes juve edhe gjithë qytetarët e komunës se ne do të bëjmë disa ndryshime në administratën komunale, këto ndryshime do të bëhen me të vetmin qëllim, lehtësimin e procedurave për kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve. Tek zyra e gjendjes civile do të ketë sportele edhe për zyrtar të tjerë si ai i pagesës së tatimit në pronë, pagesa e mbeturinave dhe zyrtari që bënë lëshimin e certifikatave të pronës. Do të vendosët edhe ashensori, këtë do të bëjmë përmes projektit të fituar në MAP, vendosja e ashensorit do t'ju mundësoj që të kenë takime me kryetarin, drejtorët dhe zyrtarët tjerë komunal e personave me aftësi të veçanta.

Do të punojmë bashkë, përkrahjen nga udhëheqja komunale do ta keni secili nga ju.

Procesverbali nga takimi me punonjësit e administratës komunale i Kryetarit të Komunës së Rahovecit



Procesverbali nga takimi me punonjësit e administratës komunale i Kryetarit të Komunës së Rahovecit

Kryetari falënderoi të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë, me kaq përfundoi takimi.

Takimi përfundoi në ora 09:50 minuta.

Përgatiti: Qëndresa Duraku



Zyrtare për Marrëdhënie me Publikun-Zyra e Kryetarit

Rahovec

21 janar 2022